



Këshillim GBS/GTS: Ndhmë me regjistrimin në programin gjithë-ditor

Të dashur prindër,

Dëshironi ta regjistroni fëmijën tuaj për kujdesin gjithë-ditor dhe drekë në shkollë dhe keni nevojë për ndihmë për plotësimin e aplikimeve? Ekipi ynë i këshillimit GBS/GTS do t'ju ndihmojë me kënaqësi. Ne do t'i shqyrtojmë aplikimet me ju dhe do t'ju ndihmojmë të llogaritni të ardhurat që do të merren parasysht, si dhe zbritjet e mundshme.

Ja se si mund t'ju mbështesim:



përmes E-Mail në **gsb-beratung@bsfb.hamburg.de**



me telefon në **040 - 42863 3579**

- të martëve nga ora 14 - 16,
- të mërkurave dhe të enjteve nga ora 10 - 12,



personalisht, nëse keni caktuar më parë një takim me ne me email ose telefon.

Ju mund të na gjeni te



- **Qendra për Informacion Shkollor dhe Rinor (ZSJ)**

Hamburger Straße 125a

22083 Hamburg

(3 minuta në këmbë nga stacioni i metrosë *U3 Hamburger Straße*)

Të gjitha informacionet rreth kujdesit gjithë-ditor në shkollat e Hamburgut mund të gjenden gjithashtu në hamburg.de/schulen/ganztag



Duhet të dini se:

- Ekipi këshillimor GBS/GTS nga ZSJ mund të ofrojë mbështetje vetëm gjatë plotësimit të aplikimeve të reja dhe të ndryshimeve.
- Aplikimet përpunohen nga shkolla. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me një aplikim që tashmë e keni dorëzuar, ju lutemi të kontaktoni zyrën e shkollës suaj.
- Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me njoftimin tuaj të tarifës, ju lutemi përdorni adresën e email-it dhe numrin e telefonit të dhënë në të.
- Për çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e kujdesit për fëmijët të ofruara në vend, është përgjegjës menaxhmenti i GBS/GTS në shkollën tuaj.